



Informohuni:

**Ulni rrezikun e kancerit
të zorrës së trashë**





Ulni rrezikun e kancerit të zorrës së trashë

Çfarë është kanceri i zorrës së trashë?

Kanceri i zorrës së trashë (ose kolorektal) ndodh në zorrën e trashë ose në rektum.



Për fat të mirë, ekzaminimet rutinë mund të ndihmojnë në parandalimin ose zbulimin e hershëm të tij, kur trajtimi shpesh funksionon më së

miri. Ekzistojnë metoda të ndryshme për ekzaminimin e kancerit të zorrës së trashë. Kolonoskopitë i lejojnë ofruesit e kujdesit shëndetësor që të zbulojnë dhe të heqin polipet (zmadhimet) nga zorra e trashë ose nga rektumi, për të ndihmuar në parandalimin e kancerit. Metoda të tjera (për shembull testet e jashtëqitjes) kërkojnë një kolonoskopi vijuese për personat që rezultojnë pozitivë.

Shenjat dhe simptomat

Simptomat e kancerit të zorrës së trashë përfshijnë gjak në jashtëqitje ose në rektum, humbje në peshë, diarre ose kapsllëk që nuk largohet. Personat me kancer të zorrës së trashë shpesh nuk shfaqin menjëherë shenja; ata duhet të ekzaminohen edhe nëse ndihen të shëndetshëm.



Faktorët e rrezikut

Ju mund të keni rrezik të lartë, nëse keni:

- Histori në familje me kancer të zorrës së trashë ose polipe parakanceroze
- Polipozë familjare adenomatoze (Familial adenomatous polyposis, FAP) ose kancer kolorektal jopolipoz të trashëguar (hereditary nonpolyposis colorectal cancer, HNPCC), i quajtur edhe si sindroma Lynch
- Kolit ulcerativ ose sëmundje të Crohn-it

Nëse keni ndonjë prej këtyre faktorëve të rrezikut, flisni me ofruesin e kujdesit shëndetësor. Mund t'ju duhet që ta filloni ekzaminimin herët në kohë.



Nëse nuk keni sigurime, mund të kualifikoheni për t'u regjistruar për një mbulim pa kosto ose

me kosto të ulët. Telefononi në numrin 347-665-0214 ose dërgoni mesazh me tekstin "**COVEREDNYC**" në numrin 55676 për ndihmë falas për regjistrimin. Për të mësuar më shumë rreth ekzaminimit pa kosto ose me kosto të ulët, vizitoni nyc.gov/health/coloncancer dhe klikoni listën me zbritje "Payment" (Pagesa).



Testet ekzaminuese

Ekzistojnë disa metoda të ekzaminimit për kancer të zorrës së trashë, duke përfshirë testet vizuale dhe testet e jashtëqitjes. Testet e renditura më poshtë dhe që ndiqen nga një yllth (*), kërkojnë kolonoskopi **vijuese të shpejtë** për personat që rezultojnë pozitivë.



Testet vizuale kërkojnë për inde të pazakonta në zorrën e trashë ose në rektum:

- **Kolonoskopia**
- **Sigmoidoskopia fleksibël***
- **Kolonografia me Tomografi kompjuterike (Computerized tomography, CT)***



Testet e jashtëqitjes kërkojnë për shenja kanceri në jashtëqitje:

- **Testi imunokimik fekal (Fecal immunochemical test, FIT)***
- **Testi me ndjeshmëri të lartë, me bazë guajaku, i gjakut okult fekal (High-sensitivity guaiac-based fecal occult blood test, HSgFOBT)***
- **Testi i ADN-së në feçe, për qëllime të shumëfishta (FIT-DNA)***

Për më shumë informacion rreth këtyre opsioneve të ekzaminimit, vizitoni nyc.gov/health dhe kërkonit për “**colon cancer screening**” (ekzaminimi për kancer të zorrës së trashë).

Pyetjet më të shpeshta

Kur duhet të filloj ekzaminimin për kancerin e zorrës së trashë?

Flisni me ofruesin e kujdesit shëndetësor rreth rrezikut. Shumë persona duhet ta fillojnë ekzaminimin në moshën 45 vjeçare. Personat me rrezik më të lartë mund të duhet që ta fillojnë më herët.

Ndihem i shëndetshëm. A duhet të ekzaminohem gjithsesi?

Kanceri i zorrës së trashë mund të mos shkaktojë menjëherë simptoma. Edhe nëse ndiheni të shëndetshëm, duhet që të ekzaminoheni. Gjetja dhe heqja e hershme e polipeve mund të ndihmojë në parandalimin e kancerit të zorrës së trashë.

Cili test ekzaminues është më i mirë?

Secili test ekzaminues ka përfitime dhe rreziqe të ndryshme. Pyesni ofruesin e kujdesit shëndetësor rreth opsioneve tuaja, për të mësuar se cili test i përshtatet nevojave tuaja.

Çfarë ndodh pas testit?

Mos harroni të ndiqeni te mjeku. Pyesni mjekun tuaj se kur duhet ta bëni ekzaminimin tjetër për kancerin e zorrës së trashë.

A do ta mbulojë sigurimi ekzaminimin?

Pjesa më e madhe e planeve të sigurimit, duke përfshirë Medicaid dhe Medicare, i mbulojnë ekzaminimet e kancerit të zorrës së trashë duke filluar nga moshë 45 vjeçare, për personat me rrezik mesatar dhe më herët për personat që kualifikohen. Megjithatë, mbulimi mund të ndryshojë. Kontaktoni ofruesin e kujdesit shëndetësor dhe ofruesin e sigurimeve rreth mbulimit, përpara testit ekzaminues.



Mënyra të tjera për të ulur rrezikun:

- Ruani një peshë të shëndetshme dhe qëndroni aktivë fizikisht.
- Hani më pak mish të përpunuar (si pastërma, salsiçe ose proshuta).
- Nëse pini duhan, planifikoni që ta lini. Për ndihmë që ta lini, telefononi në numrin **311** ose vizitoni faqen e internetit **nyc.gov/nycquits**.
- Konsumi i alkoolit mund të rrisë rrezikun e kancerit në zorrën e trashë. Vizitoni **nyc.gov/health** dhe kërkoni “**alcohol and health**” (alkooli dhe shëndeti) për më shumë informacion.

Më shumë informacion

Vizitoni **nyc.gov/health/coloncancer**

American Cancer Society:

cancer.org/cancer/colon-rectal-cancer

Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve:

cdc.gov/cancer/colorectal

Instituti Kombëtar i Kancerit:

cancer.gov/types/colorectal

Departamenti i Shëndetit të Shtetit të Nju Jorkut:

health.ny.gov/diseases/cancer/colorectal